

Nr. _____ Prot.,

Tiranë, me _____.____2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Mirëmbajtje hardware dhe software të sistemit të gjurmueshmërisë dhe menaxhimit të brendshëm, me kushtin ndërprerjen e kontratës, pas lidhjes së kontratës me objekt “Furnizim, instalim dhe konfigurim i pajisjeve IT, sistemeve të kontrollit të aksesit dhe softuereve”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): **50312310-1 - Mirëmbajtje e pajisjeve të rrjetit të të dhënave.**

Vlera e fondit limit: 16,959,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë) lek pa TVSH ose 180,934.60 (njëqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 14.07.2026 është 93.73 lek.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor ”Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, nenit 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilat parashikohet se:

- Neni 82, i LPP-së, pika 1: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet nën rregullat e prokurimit publik”.
- Neni 83 i LPP-së: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” dhe pikën 1 të nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”... “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43, pika 2/c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe Nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% e fondit limit që prokurohet. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 41, pika 3 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 për “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 2 (dy) Inxhinierë IT/Specialistë IT në stafin e vet, të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, çertifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. Vetëm ky staf do të kryejë ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese dhe korrigjuese.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pra që kanë në dispozicion për përmbushjen e kësaj kontrate.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, termave të referencës, proceset e realizimit të shërbimit objekt prokurimi.

Numri i punonjësve është vlerësuar i tillë në përputhje me proceset e punës dhe detyrat që do të kryhen, në përputhje me specifikimet teknike dhe termat e referencës.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë **2 (dy)* Inxhinierë IT/Specialistë IT** është vendosur për të garantuar që shërbimet që do të realizohen nga personel i kualifikuar, në përputhje me kërkesat teknike dhe ligjore në fuqi. Duke qenë se objekti i kontratës lidhet me pajisje software dhe hardware është e domosdoshme që mirembajtja të kryhet nga specialistë të kualifikuar. Kërkesa për një numër minimal prej 2 (dy) specialistësh është përcaktuar për të siguruar që operatori ekonomik të ketë kapacitetet e nevojshme njerëzore për realizimin e shërbimeve në mënyrë të vazhdueshme si dhe për të garantuar realizimin e kontratës brenda afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu, kjo kërkesë siguron që operatori ekonomik të ketë personel të mjaftueshëm për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale edhe në rast të mungesave të përkohshme të njërit prej specialistëve. Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se këto kërkesa nuk krijojnë kufizime të pajustificuara të konkurrencës, pasi janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe janë të domosdoshme për verifikimin e kapacitetit teknik e profesional të operatorëve ekonomikë që do të marrin pjesë në procedurë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autodeklaratë ku garanton se në rast të shpalljes fitues, do të kryejë **shërbimin e mirëmbajtjes**, riparimin dhe zëvendësimin e çdo defekti/pjese të mundshme/gjatë periudhës së kontratës, për pajisjen dhe të gjithë aksesorëve **të cilat janë të lidhura me pajisjen**, në mënyrë që ajo të jetë në shërbim të stafit dhe të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e shërbimit.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se mirembajtja dhe riparimi do të realizohet në kohë dhe në vendndodhjen përkatëse të caktuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik provon aftësinë teknike nëpërmjet: a) autorizimit/certifikimit nga prodhuesi i software-it (ePartner) për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes; ose b) marrëveshjes së nënkontraktimit/partneritetit me prodhuesin ose me një subjekt të autorizuar prej tij.

Argumentimi: Software-i TrAce është vepër e mbrojtur nga e drejta e autorit, pronësi e prodhuesit ePartner. Autoriteti Kontraktor e përdor si përdorues i licencuar dhe nuk zotëron të drejta mbi kodin, as të drejtën e modifikimit apo të transferimit të tij te të tretë.

Për rrjedhojë, ndërhyrja teknike në sistem nga një subjekt i paautorizuar nga prodhuesi cenon të drejtat e tij, sjell humbjen e garancisë dhe e privon Autoritetin Kontraktor nga çdo rekurs në rast defekti. Gjithashtu, sistemi dokumenton gjurmueshmërinë e ciklit të sterilizimit të instrumentarit kirurgjikal; ndërhyrja e pakontrolluar në të cenon integritetin e të dhënave dhe sigurinë klinike.

Kufizimi nuk buron nga vullneti i Autoritetit Kontraktor, por nga regjimi i mbrojtjes së pronësisë intelektuale mbi produktin.

Proporcionaliteti: Kriteri nuk emërton dhe nuk favorizon asnjë operator të caktuar. Ai është i hapur ndaj çdo subjekti të autorizuar nga prodhuesi, si dhe ndaj çdo operatori që siguron nënkontraktim/partneritet me prodhuesin ose me një partner të tij. Përbën minimumin e domosdoshëm për kryerjen e ligjshme dhe të sigurt të shërbimit, në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162/2020.

Paraqitja e autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar shërben për të vërtetuar se operatori ekonomik është i autorizuar të mirëmbajë rrjetin, si dhe garanton aksesin në mbështetjen teknike, përditësimet e nevojshme, pjesët zëvendësuese dhe shërbimet e garancisë gjatë periudhës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Për rrjedhojë, kërkesa për paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar vlerësohet si e nevojshme, proporcionale dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, me qëllim garantimin e realizimit me sukses të saj dhe mbrojtjen e interesave të Autoritetit Kontraktor. Funksionimi i tyre kërkon standarde të larta besueshmërie, origjinaliteti dhe mbështetjeje teknike nga prodhuesi, për të garantuar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemit gjatë gjithë ciklit të tij të jetës.

2.3.5. Operatori Ekonomik duhet të lëshojë një Deklaratë me anë të së cilës **merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij** gjatë kohës në ambientet e punës, dhe kjo e fundit nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të Operatorit Ekonomik në ambientet e saj.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Autodeklarate** me anë të së cilës **të përcaktojë më shumë se një person kontakti për raportimin e defekteve** dhe çështjeve administrative, për të cilët duhet të bëjë me dije Autoritetin Kontraktor (telefon dhe email). Çdo ndryshim kontakti duhet të raportohet menjëherë me shkrim palëve. Stafi (i të Kontraktuarit) duhet të jetë i pajisur me kartë (mjet) identifikimi personal gjatë vizitave në ambjentet e Kontraktuesit dhe të shoqerohet nga stafi Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Keto kërkesa vendosen në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi merr përsipër ekzekutimin e kontratës/ave, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 9 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për keto pika do të jete kusht skualifikimi.

Autoriteti Kontraktor mund të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s’kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me nenin 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT